



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

RAPORT - TM3 2023

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A. – PRIZREN

PËRMBAJTJA

I.	ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE	4
II.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	5
III.	DEPARTAMENTI TEKNIK	6
3.1	PRODHIMI m3 – TM2-2023	6
3.2	SITUATA E FURNIZIMIT.....	7
3.3	AKTIVITETET KRYESORE.....	7
3.3.1	AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE	8
3.3.2	MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFEKTEVE	9
3.3.3	SHËRBIMI PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM	9
3.3.4	SERVISIMI I UJËMATËSAVE.....	10
3.3.4	DETEKTIMI I RRJETIT	11
3.3.5	CILËSIA E UJIT	11
3.4	PROBLEMET E EVIDENTUARA	12
3.5	MASAT E REALIZUARA.....	12
3.6	MASAT E PROPOZUARA.....	12
IV.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL	13
4.1	PERFORMANCAT – TM2-2023	13
4.1.1	NUMRI I KONSUMATORËVE.....	13
4.1.2	FATURIMI – m3.....	14
4.1.3	FATURIMI – €	15
4.1.4	ARKËTIMI – €	16
4.2	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	17
4.2.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	17

4.2.2	ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE.....	17
4.2.3	INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA.....	18
4.2.4	PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE.....	19
4.2.5	MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE.....	19
4.2.6	MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHEN NË VAZHDIM.....	20
V.	DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	20
5.1	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE	20
5.1.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	20
5.1.2	ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE.....	21
5.1.3	PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE.....	23
5.1.4	MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE.....	23
5.1.5	MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHË NË VAZHDIM	23
5.2	TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS.....	Error! Bookmark not defined.
VI.	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE.....	24
6.1	NJËSIA OPERATIVE- PRIZREN	24
6.2	NJËSIA OPERATIVE- SUHAREKË.....	25
6.3	NJËSIA OPERATIVE- DRAGASH.....	26
6.4	NJËSIA OPERATIVE- MALISHEVË.....	27
6.5	KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN	28
6.5	KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN	29
6.6	REALIZIMI I CAQEVE- TM2-2023	30
	REALIZIMI I CAQEVE- GJM1-2023	Error! Bookmark not defined.
6.7	TRANSAKSIONET KRYESORE- TM1-2023.....	31
VII.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	32
7.1	KOMENTET KRYESORE.....	32
7.1	PERSONELI	Error! Bookmark not defined.

7.2	ZYRA LIGJORE	Error! Bookmark not defined.
VII.	DEPARTAMENTI I UN -ITUN	46
7.1	KOMENTET KRYESORE.....	46
7.1.1	FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN	46
VIII.	AUDITIMI I BRENDSHËM.....	47
IX.	AKTIVITETET E PROKURIMIT – TM2-2023	47
X.	INVESTIMET KAPITALE.....	52
XI.	ZBATMI I STRATEGJISË PËR ZVOGLIMIN E UPF-së	53
XII.	RAPORTIM FINANCIAR PËR MINISTRIN E FINANCAVE	56
XIII.	ORGANOGRAMI	57

I. ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SE K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, viti 2023



Punoi: Shërbimi TEKNIK

LEGJENDA:	
05	Zona e shërbimit
06	Qytetet me ujë
07	Kombinatet me ujë që funksionojnë nga 1980
1.18	Niveli i mbulimit me shërbime të ujësjellësit


II. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

III. DEPARTAMENTI TEKNIK

3.1 PRODHIMI m3 – TM2-2023

Tabela Nr.1 - Prodhimi – TM3 2023

TM1-TM2-TM3-TM4- 2023						
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN						
P R O D H I M I - m 3						
NJËSIA PUNUESE	TM1-2023		TM2-2023		TM3-2023	
	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	331.0	2,573,700	691.3	5,435,185	788.3	6,197,753
SUHAREKË	81.3	632,050	138.3	1,087,135	168.1	1,321,810
MALISHEVË	46.6	362,407	90.4	710,935	87.8	690,625
DRAGASH	31.9	247,800	31.4	247,247	33.0	259,183
TOTAL	490.7	3,815,957	951.4	7,480,502	1,077.2	8,469,371
NDRYSHIMI			116.20	3,664,545	125.77	988,869
NDRYSHIMI %				96.03%		13.22%



3.2 SITUATA E FURNIZIMIT

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes për muajt Korrik-Shtator të vitit 2023, në nivel rajonal, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë i plotë dhe i rregullt. Përfshirje shumë të vogla dhe të pjesëshme të furnizimit në disa lokalitete janë shfaqur kryesisht nga prishjet teknike në rrjet dhe pusët furnizuese.

Në muajt Korrik-Shtator kemi realizuar furnizimin stabil, kualitativ dhe kuantitativ duke përmbushur standardet aplikative për furnizim 24h dhe cilësi 100 % të ujit të pijes dhe duke ndërmarrë në vazhdimësi aktivitetet e duhura në operim dhe mirëmbajtje për funksionim optimal të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Furnizimi stabil dhe i kënaqshëm rezultohet kryesisht nga mbizotërimi i kushteve atmosferike dhe investimeve të vazhdueshme në përmirësimin e rrjetit në përgjithësi me theks të veçantë në zonat problematike të furnizimit.

3.3 AKTIVITETET KRYESORE

- Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme të punëve konform detyrimeve dhe përgjegjësi të vendit të punës dhe jashtë tyre për operimin dhe funksionimin optimal të Departamentit të ujit të pijes në veçanti dhe Kompanisë në përgjithësi.
- Takimet e rregullta ditore, javore e mujore, të menaxhmentit, me bashkëpunëtorët, me udhëheqësat e njësisë punuese në varësi dhe shërbimet tjera të Kompanisë.
- Takimet me institucionet komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, operatorët ekonomik, me konsumatorë, palë tjera të interesit, etj.
- Raportet e rregullta, raportet e veçanta dhe specifike, përgjigjet, shkresat, komentet dhe shkëmbimet përmes komunikimeve elektronike e fizike për menaxhmet, KE, BD, ARRU, IM, KNMU dhe Institucionet e agjencionet tjera monitoruese dhe ndërvepruese në sektorët e ujit dhe energjisë në funksion të përgjegjësi dhe përmbushjes së detyrimeve karshi standardeve të shërbimit
- Menaxhimi, procedimi, mbikqyrja dhe procesimi i projekteve të investimeve kapitale sipas planifikimeve të PB 2023 dhe projekteve e aktiviteteve tjera investive e operative të Kompanisë
- Revidimi dhe procesimi final për aprovim nga BD të dokumenteve:
 - Revidimi i PB 2023-2025
 - Strategjia për zvogëlimin e humbjeve të ujit 2023-2025
 - Plani i veprimit për implementimin e strategjisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit për vitin 2023.
- Procedimi, monitorimi dhe kontributi në procedimin e realizimin e Marrëveshjes me Komunën e Malishevës, nr. 2394/17.07.2023, për mbështetje financiare në realizimin e projektit:
 - Furnizimi me pjesë fazonike hidroteknike për projektin “Ndërtimi i infrastrukturës së re të rrjetit të ujësjellësit në rrugën ‘Ibrahim Mazreku’ – Malishevë”.
 - Furnizimi me elektropompa shtytëse për stacionin e pompimit – Bajë, komuna e Malishevës
 - Vlera investive e përbashkët - 71,000.00 Euro
- Përgatitja e projektdokumentacionit investiv për realizim të marrëveshjes bashkëinvestuese me komunën e Dragashit për 3 projekte:
 - Rehabilitimi i rrjetit të vjetër të ujësjellësit në Dragash.

- Ndarja e lokacionit komunal për ndërtimin e objektit administrativ e operativ për NJP Dragash.
- Ofrimin e shërbimeve specifike nga Kompania sipas nevojave dhe kërkesave të Komunës së Dragashit.
- Vazhdimi i aktiviteteve për realizimin e Marrëveshjeve të reja bashkëinvestuese me komunën e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit dhe institucioneve potenciale financiare.
- Procesimi i projektit të efikasitetit të energjisë mbështetur nga KFW për energjinë alternative përkatësisht instalimin e pasqyrave fotovoltaike (solare) në 6 lokacione të përzgjedhura të NJP të Kompanisë.
- Njoftimet Inspektorateve pranë MMPHI-së për procedimin dhe zyrtarizimin e aplikacioneve për ARPL – MMPHI, për vazhdimin e lejeve ujore dhe paisjet me lejet e reja ujore për burimet e vogla sipas kriterëve përcaktuar nga UA nr. 03/2018 dhe urdhëresave të evidentuara në proceverbalin nr, 01379 lëshuar nga inspektorati i MMPHI-së.
- Inspektimet Njësive Punuese për mbështetje dhe evidentim të vështirësive, nevojave e kërkesave (Suharekë, Malishevë dhe Dragash)
- Inspektimet e të gjitha Njësive Punuese, shërbyese e operative konform Vendimit nr. 3232/31.08.2023 rreth paisjes së punëtorëve për mbrojtje të shëndetit, kushteve të punës dhe paisjeve, makinerisë e veglave të nevojshme për punë dhe përpilimin e raporteve përkatëse.
- Inspektimet në teren, fshati Kushtendil dhe Guri I zi për realizimin e projekteve për burime të reja për furnizim me ujë për lagjen “UÇK”-Prizren.
- Takim me përfaqësuesit e ARRU rreth diskutimeve për gjendjen e prodhimit të raportuar në nivel të kompanisë.
- Realizimi i infrastrukturës pompuese dhe sigurimi i furnizimit me ujë të pijes për pushimore nga st. Pomp. – Sozi Nashec.
- Detalizimi final i Marrëveshjes ekzistuese me Telekomin e Kosovës për shërbime telekomunikuese për punëtorët e Kompanisë.
- Monitorimi dhe menaxhimi profesional i stacioneve e sistemeve elektropompuese, monitoruese e komanduese dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e operimin efikas të tyre.
- Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak në cilësinë e menaxherit të projekteve. menaxhimi i kontratave në zbatim me OE vendor dhe ndërkombëtar, Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi dhe procesimi për pagesë i shpenzimeve mujore energjetike e telekomunikuese, përkrahjen dhe ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e paramasave, parallogarive dhe projektdokumentacione investive propozuese dhe kujdesi për mbarëvajtjen funksionale të infrastrukturës së gjithëmbarshme fizike të njësive punuese të Kompanisë.

3.3.1 AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE

- ✚ Riorganizimi dhe ristrukturimi i shërbimeve brenda DUP-së konform procesit në vazhdim të sistematizimit dhe organogramit të ri të Kompanisë me objektiv të veçantë në divizionin për UPF.
- ✚ Përpilimi i planeve operative ditore dhe periodike me të gjitha shërbimet përkatëse dhe intervenimet në sanimin e prishjeve në rrjetë, rrjedhjeve të pakontrolluara, shkyçjen e lidhjeve ilegale, etj.

- ✚ Instalimi dhe finalizimi i vendosjes së ujëmatësve të prodhimit në të gjitha pikat furnizuese në nivel të kompanisë.
- ✚ Detektimi i rrjetit të ujësjellësit, ndërrimi i ujëmatësve dhe ndarja e zonave për detektim për zvogëlimin dhe eliminimin optimal të humbjeve teknike.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit dhe segmenteve tjera në zonën e mbulueshmërisë me prishje të shpeshta dhe jofunksionalitet të duhur sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemet monitoruese aplikative, shërbimit operativ dhe matjeve në teren. përmes investimeve të vazhdueshme vetanake dhe bashkëinvestimeve me komunat, qeverinë dhe institucionet tjera financiare.
- ✚ Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve për trajtim dhe shfrytëzim racional të ujit të pijes për sigurimin e furnizimit të plotë dhe të pandërprerë në tërë zonën menaxhuese.
- ✚ Qendruhmëria financiare si parakusht për investime të vazhdueshme në infrastrukturën fizike dhe humane me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore në tërë fushëveprimtarinë e Kompanisë.

3.3.2 MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFEKTEVE

Tabela Nr.4 – Sanimi i defekteve – TM3 2023

Njësia Operative	Ujësjellësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	566	127	693
Suharekë	114	29	143
Dragash	18	07	25
Malishevë	41	11	52
Total	739	174	913

3.3.3 SHËRBIMI PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM

- ✚ * Përpilimi i raporteve për muajt Korrik-Shtator, 2023.
- ✚ * Përpilimi i pëlqimeve, përgjigjeve në kërkesa për konsumatorët.
- ✚ * Përgatitja e dy të arriturave javore për departamentin e ujit të pijes.
- ✚ * Inspektimi i ujëmatësve të prodhimit nga ARRU (Zogë Spahiu).
- ✚ * Projekti i rrugës “Nënë Tereza”-Prizren, është dërguar në Komune.
- ✚ * Përgatitja e projekteve për KASH, 2024-2026.
- ✚ * Rividimi i PB për 2023-2025.
- ✚ * Plan Bisnes 2024-2026, prodhimi dhe projektet investive.
- ✚ * Aplikimi për vazhdimin e Lejeve Ujore në MMPH – Prishtinë.
- ✚ * Takim pune me ARRU - Vebi Durakun – raporti i ZKA-së dhe PMA.
- ✚ * Inspektim nga ARRU (prodhimi) – Zogë Spahiu, Albana Abazi dhe Hysni Feka.
- ✚ * Përpilimi i listës “Pasqyrimi i resurseve ekonomike sipas rajoneve zhvillimore”-Adem Ametaj.
- ✚ * Komentet për INSI-n në kuader të raportit për burimet e ujit në jug-përendim të Prizrenit.
- ✚ * Plotësimi i platëformës Bechmarking – takim në Prizren (Albani Thaqi dhe Ilire Bujari).
- ✚ * Përpilimi i dokumentacionit për staf të kompanisë në E-Prokurim.
- ✚ * Përgatitja e projekt propozimit për SCADA sistem (Ariani, Alberti dhe Besari).

- * Inicimi i projekteve për realizim.
- * Menaxhimi i kontratave në sistemin e Prokurimit.
- * Vlersimi i kontratave në Prokurimit.
- * Mbikqyrje të projekteve në kuadër të KRU “HRJ”.
- * Takim pune në K.Komunal me Ejupin, Fejsalin dhe Hatixhen për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe atë që janë në plan nga K.Komunal si dhe mundësia e vazhdimi i bashkëpunimit ndërmjet dy insitucioneve.
- * Vizita në teren në kuadër të projekteve: “Grençar” dhe të “Guri i zi” për lagjen UÇK.
- * Vazhdimi i punimeve në projektet: Rr.“Xhavit Syla” dhe fshati “Bllacë” në Suharekë, fshati “Banjë” dhe rrugët në Malishevë, rrugët: “Gucia”, “Avdi Shala” dhe “Drejtësia” në Prizren.
- * Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevoja të kompanisë.
- * Pasurimi i GIS-it me të dhëna.

3.3.4 SERVISIMI I UJËMATËSAVE

Tabela Nr.5– Servisimi i ujëmatësve – TM3 2023

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Korrik-Shtator-2023	
Kalibrim i ujëmatësve (Bazhdarim)	269	riparime të ujëmatësve
	5	ekspertiza
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	589	vizita të konsumatorët
	351	ndërrime të ujëmatësve
	83	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Bllombimit	264	bllombim dhe kontrata
	788	Konsumatorët pa qasje (dera e mbyllur-mospresencë
	53	kërkesa nga konsumatorët për bllombim

3.3.4 DETEKTIMI I RRJETIT

Tabela Nr.7– detektimi – TM3 2023

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Korrik-Shtator-2023	
	191	detektime
	116	defekte të gjetura
	4,240	rrjet i detektuar (m)

3.3.5 CILËSIA E UJIT

Kontrrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet dhe në fshatra.
 Kontrrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe të puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.
 Kontrrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit për të përcjellur punën e procesit të klorinimit dhe paisjeve.
 Furnizim i stacioneve të klorinimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.
 Marrja e mostrave sipas Planit për monitorim të cilësisë së ujit.
 Regulluar injektorin e klorinimit në sistemin e klorinimit në Shadrvan në ϕ 400.
 Organizuar pastrimin e Filtrave në Koagulator në Dragash.
 Defektin në dozatorin e Hipokloritit të Natriumit në Zojzë e regulluar .
 Defektin në dozatorin të Hipokloritit të Natriumit në Medvec e regulluar.
 Riparuar sistemin e klorinimit në Muradem.

Tabela Nr.9 – Analizat bakteriologjike –IKSHP- TM3 2023

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	34	34
	Ujësuellës	130	130
Suharekë	Burim	8	8
	Ujësuellës	24	24
Dragash	Burim	6	6
	Ujësuellës	20	20
Malishevë	Burim	6	6
	Ujësuellës	22	22
Totali	Burim	108	33
	Ujësuellës	392	0

Vërejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike dhe kimike të marrura në rrjetin e ujësjellësit është 392 mostra, ku të gjitha mostrat i përgjigjen standarteve.

3.4 PROBLEMET E EVIDENTUARA

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

3.5 MASAT E REALIZUARA

- Te gjitha defektet ne sistem te ujesjellesit dhe kanalizimit jane sanuar me kohe,
- Eshte percjell ne menyre permanente cilesia e ujit te pijes ne nivel regjional,
- Eshte pergaditur dhe miratuar strategjia e UPF-se.

3.6 MASAT E PROPOZUARA

- Monitorimi i furnizimit me uje te pijes ne gjith zonen e sherbimit,
- Monitorimi i cilesise se ujit te pijes ne nivel regjional,
 - Vazhdimi i analizes se rrejtit te ujesjellesit dhe kanalizimit si dhe bartja e te dhenave ne GIS,
 - Fillimi i implementimit te strategjise per uljen e UPF-se.


IV. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

4.1 PERFORMANCAT – TM2-2023

4.1.1 NUMRI I KONSUMATORËVE

Tabela Nr.11 – Numri i konsumatorëve – TM1-TM2-TM3- 2023


NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA				
No.	Të dhënat	TM1- 2023	TM2-2023	TM3-2023
1	Shtëpiak	50,353	50,789	51,409
2	Ndryshimi		436	620
3	Ndryshi. %		0.87%	1.22%
4	Kome.-Indu.	6,369	6,428	6,521
5	Ndryshimi		59	93
6	Ndryshi. %		0.93%	1.45%
7	Institucional	346	348	340
8	Ndryshimi		2	(8)
9	Ndryshi. %		0.58%	-2.30%
10	TOTAL	57,068	57,565	58,270
11	Ndryshimi		497	705
12	Ndryshi. %		0.87%	1.22%



4.1.2 FATURIMI – m3

Tabela Nr.12 – Faturimi m3 – TM3 2023


FATURIMI - m3				
No.	Të dhënat	TM1- 2023	TM2- 2023	TM3- 2023
1	Shtëpiak	1,487,459	1,612,817	2,046,163
2	Ndryshimi		125,358	433,346
3	Ndry. %		8.4	26.9
4	Kome.-Indu.	149,221	169,440	283,209
5	Ndryshimi		20,219	113,769
6	Ndry. %		13.5	67.1
7	Institucional	119,996	126,053	139,284
8	Ndryshimi		6,057	13,231
9	Ndry. %		5.0	10.5
10	TOTAL	1,756,676	1,908,310	2,468,656
11	Ndryshimi		151,634	560,346
12	Ndry. %		8.6%	29.4%



4.1.3 FATURIMI – €

Tabela Nr.13 – Faturimi €– TM3 2023

FATURIMI - €				
No.	Të dhënat	TM1- 2023	TM2- 2023	TM3- 2023
1	Faturimi-€	1,210,353.03	1,297,938.64	1,635,576.24
2	Total- Shte.	921,657.44	987,222.64	1,211,336.14
3	Ndryshimi	(7,388.32)	65,565.20	289,678.70
4	Ndry. %	(0.02)	7.1%	31.4%
5	Total- kome.	179,444.91	196,060.35	297,147.10
6	Ndryshimi		16,615.44	117,702.19
7	Ndry. %		9.3%	65.6%
8	Total-Inst.	109,250.68	114,655.65	127,093.00
9	Ndryshimi		5,404.97	17,842.32
10	Ndry. %		4.9%	16.3%
11	Te tjera	20,852.74	8,819.75	13,762.89
12	Total	1,231,205.77	1,306,758.39	1,649,339.13
13	Ndryshimi		75,552.62	418,133.36
14	Ndry. %		6.1%	34.0%




4.1.4 ARKËTIMI – €

Tabela Nr.14 – Arkëtimi €– TM3 2023

No.	Të dhënat	TM1- 2023	TM2- 2023	TM3- 2023
1	Total- Shtëpiak	947,601.64	895,209.14	1,230,442.08
2	Ndryshimi		(52,392.50)	335,232.94
3	Ndry. %		-5.5%	37.4%
4	Total-Komercial-Industrial	152,857.59	205,901.46	273,061.36
5	Ndryshimi		53,043.87	67,159.90
6	Ndry. %		34.7%	32.6%
7	Total Institucional	78,329.95	96,382.20	119,119.29
8	Ndryshimi		18,052.25	22,737.09
9	Ndry. %		23.0%	23.6%
10	Total - ujë	1,178,789.18	1,197,492.80	1,622,622.73
11	Ndryshimi		18,703.62	425,129.93
12	Ndry. %		1.6%	35.5%
13	Te tjera	18,753.02	8,847.28	13,080.22
14	Ndryshimi		(9,905.74)	4,232.94

15	Ndry. %		-52.8%	47.8%
16	TOTAL	1,197,542.20	1,206,340.08	1,635,702.95
17	Ndryshimi		8,797.88	429,362.87
18	Ndry. %		0.73%	35.59%



4.2 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL

4.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi një faturim më të madh në krahasim me tremujorin paraprak, kjo rritje është rezultat i rritjes së konsumit gjatë periudhës së verës si dhe ardhjes së bashkatdhetarëve në vendlindje.
- Kemi një inkasim më të madh në krahasim me tremujorin paraprak, si rezultat i shtimit të aktiviteteve në teren gjatë kohës së ardhjes së diasporës.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.

4.2.2 ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.
- Janë shqyrtu ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Tabela Nr.16 – Ankesat teknike dhe komerciale – TM2 2023

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	676
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	676
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	142
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	142
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	142

Tabela Nr.16 – Ankesat teknike dhe komerciale – TM3 2023

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	1,031
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	1,031
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	240
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	240
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	240

4.2.3 INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA

Kanë vazhduar kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.18 – Raport i inspektimit – TM2 2023

Njësitë operative	Shpërndarja e njoftimeve paralajmëruese për përmbartim	Konsumatorët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkyçjeve	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Nr. i leximeve të gabuara	Rastet e dorëzuar për gjykatë	Vizita nga ankesat/kërkesat konsumatorëve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	4,853	415	32	40	4,194	19	43	95	134,990.67
Suharekë	631	101	2	1	2,115	10	7	31	27,357.00
Malishevë	902	186	2	2	102	12	0	5	12,171.19
Dragash	15	8	4	4	66	3	2	3	250.00
TOTAL	6,401	710	40	47	6,477	44	52	134	174,768.86

Tabela Nr.18 – Raport i inspektimit – TM3 2023

Njësiti operative	Shpërndarja e njoftimeve paralajmëruese për përmbartim	Konsumatorët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkyçjeve	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Nr. i leximeve të gabuara	Rastet e dorëzuar për gjykatë	Vizita nga ankesat/kërkesat konsumatorëve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	5,578	450	64	64	3,989	27	105	389	149,084.90
Suharekë	535	51	10	8	2,285	14	29	116	26,468.00
Malishevë	775	81	3	3	245	11	2	29	27,758.03
Dragash	2	11	3	3	71	6	0	3	0.00
TOTAL	6,890	593	80	78	6,590	58	136	537	203,310.93

4.2.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Pamundësia e identifikimit të të gjithë lidhjeve të paautorizuara që kanë vendos konsumatorët
- Moskontimi i një pjese të ujëmatësve si rezultat i amortizimit të tyre apo arsyeve teknike tjera
- Mospagesa e obligimeve të rregullta mujore nga një numër e institucioneve dhe një pjese të borgjeve të kontraktuara nga një pjesë e konsumatorëve .
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës, bizneset që kanë falemintuar dhe probleme tjera të natyrave të ngjajshme.
- Dyert e mbyllura në shumë raste po e pamundësojnë leximin e rregullt të ujëmatësve
- Trendi i rritjes së çmimeve po ndikon në mospagesën e faturave rrjedhëse tek kategoria e konsumatorëve që kanë probleme financiare

4.2.5 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyqje dhe legalizimeve.
- Kanë vazhduar aktivitetet me përmbartues privat (dalja në teren me ekipet e kontrollës, identifikimi i adresave, identifikimi i konsumatorëve, trashëgimtarëve të tyre etj
- Janë shpërndarë njoftime para inicimit të procedurës përmbartimore në terrenet e lexuesve.
- Jane vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kisteve nga kontratat për pagesën e borxhit me kiste, mirepo të kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kisteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

4.2.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHEN NË VAZHDIM

- Asistim me ekipe te inspektoratit edhe në njësit tjera
- Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbardim.
- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Ndryshimi i orarit të punës të inspektoratit (nga ora 6:00 deri 19:00 dhe vikendeve)
- Vazhdimësia e trajtimi të një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbauresi duke i ndërruar terenet e lexuesve
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kësteve.
- Vazhdimësia e mbështetjes së lexuesve nga ekipi i inspektoratit, te konsumatorët të cilët kanë problem në qasje të leximit të orëve
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që kanë pëlqime në kyqje të shërbimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit.

V. DEPARTAMENTI I FINANCAVE

5.1 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE

5.1.1 AKTIVITETET KRYESORE

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:


- Përgatitja e raporteve tremujore per TM2 2023;
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajtë përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punsuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisorisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;

- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotesimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarte të kërkuar nga ATK, për muajtë përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Raportimet tremujore ndaj ARRU-së
- Raportimet tremujore ndaj njësisë për ndërmarrjet publike;
- Raportimet tremujore ndaj Agjensisë së Statistikave të Kosovës;

5.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

Tabela Nr.19 – Shpenzimet – TM3 2023

SHPENZIMET - €				
No.	Të dhënat	TM1- 2023	TM2- 2023	TM3- 2023
1	Total Shpenzimet Operative	1,074,838.91	1,151,058.57	1,187,829.15
2	Pagat	670,794.20	712,613	717,245
3	Rryma elektrike	230,041.82	248,213	267,640
4	Shpen. e derivateve	33,017.46	20,889	31,744
5	Mirem. dhe riparimet	34,471.14	57,884	45,290
6	Mirem. e automjeteve	11,546.13	14,137	26,692
7	Shpen.e taksave	32,865.12	25,483	26,537
8	Kemikaliet	10,247.83	10,365	15,676
9	Shpenzimet e tjera	51,855.21	61,476	57,004
2	Ndryshimi		76,219.66	36,770.58
3	Ndryshimi ne %		7.09%	3.19%



Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e III-të 2023, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të II-të 2022, janë më të larta;

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo rënies së tyre;

Në pozicionin e pagave, shpenzimet e tyre në krahasim me tremujorin e kaluar janë pothuajse të njejta, pasi që nuk kemi rritje të numrit të punëtoreve, pra kjo mund të ndikojë edhe në rritje të shpenzimeve ose kur kemi angazhim më të madh të punëtoreve për punë jashtë orarit;

Edhe tek pozicioni i energjisë elektrike kemi rritje të shpenzimeve, për arsye se në sezonin e verës kemi angazhim më të madh të pompave për nxjerrje të ujit, për shkak së rritet prodhimi dhe hargjimi i ujit;

Edhe te pozicioni i derivateve kemi një rritje të shpenzimeve, për shkak se në këtë tremujor dhe çmimi i derivate ka qenë më i lartë, po ashtu kemi bërë furnizim më të madh për vajë për mirëmbajtje të pompave në ITUN;

Ndërsa rënie kemi te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, për shkak se menjëherë pas sezonit dimror, pra tre mujorin e kaluar, aktivitetet kanë qenë më të larta, ndërsa në këtë tremujor nuk kemi pasur më shumë angazhim për intervenime në mirëmbajtje se sa tremujori i kaluar;

Rritje të lartë kemi te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; në veçanti Njësinë e Prizrenit dhe njësinë e Suharekës, pasi që në këtë tremujor, ka pasur më shumë nevoj për riparime të makinerisë, duke ditur se koncentrimi dhe zona e shërbimit është më e madhe në Prizren;

Rritje të lehtë kemi edhe te shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi më shumë lëndë të dërguara tek përbaruesi, ndërsa shpenzimet të anëtarësisë mujore në SHUKOS edhe asaj të ARRU-së për vitin 2023 kanë qenë të njejta;

Rënie të lehtë kemi te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e interesit, shpenzimet e trajnimit të stafit të kompanisë, shpenzimet e provizioneve, shpenzimet e jashtme profesionale etj;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura më lartë.

5.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Edhe në këtë Tremujorsh Kompania i ka pasur sfidat në aspektin financiar:

Në krahasim me tremujorin e kaluar, faturimi këtë periudhë ka qenë më i lartë si dhe inkasimi ka qenë i knaqshm. Vazhdon të jetë problematike inkasimi të llogarive të arkëtueshme të vjetërsuara, gjë që ekzistojnë edhe në këtë periudhë. Këto llogari të arkëtueshme, vazhdojnë të procedohen tek përmbaruesi, të cilat përveç që ka vonesa relativisht të mëdha, gjithashtu rrezikohen edhe të parashkruhen nëse ato lëndë prapsohen në gjykatë.

Detyrimet kontigjente - kërkesat e punëtorëve ndaj kompanisë që kanë vendim gjykate shuma 94,000.00 euro. Ekzistojnë ende si i tillë edhe në këtë periudhë.

Obligimet ndaj KEK , për të cilin borgj ne kemi arrit marrëveshje me KEK-un për përmbushjen e obligimit për 12 vite . Obligimi vjetor është 120,768.00 euro

5.1.4 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

Për llogaritë e arkëtueshme të vjetërsuara, përveç dërgimit të lëndëve tek përmbaruesit privat, ato vazhdojnë t'i kryejnë edhe ekipet e inspektorëve nga shërbimi me konsumatorë.

Kompania vazhdon ta paguaj me kohë për borgjin ndaj KEK-ut në shumë 10,064.00 €.

5.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHË NË VAZHDIM

Të bëhen përpjekje për inkasimin e llogarive të arkëtueshme, me ekipet e inspektorëve/kotrollorve, para se ato të mund të parashkruhen, gjë që edhe në këtë periudhë kemi angazhuar edhe grupe mobile shtese për inkasim edhe gjatë fundjavës

Të bëhet “presion” ndaj përmbaruesve privat me qëllim të procedimit të lëndëve me ritëm më të shpejtuar.

VI. PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE

6.1 NJËSIA OPERATIVE- PRIZREN

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN

MUAJI	TM2-2023	TM3-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	5,435,185	6,197,753	762,568	14.0%
<i>Faturimi m3</i>	1,459,775	1,876,327	416,552	28.5%
<i>Faturimi nga uji €</i>	983,216.70 €	1,239,094.44 €	255,878	26.0%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	4,899.08 €	5,760.37 €	861	17.6%
<i>Faturimi Total €</i>	988,115.78 €	1,244,854.81 €	256,739	26.0%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	931,224.84 €	1,257,684.63 €	326,460	35.1%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	4,961.70 €	4,918.67 €	(43)	-0.9%
<i>Inkasimi Total €</i>	936,186.54 €	1,262,603.30 €	326,417	34.9%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	39,727	40,117	390	1.0%
<i>% e inkasimit</i>	94.71	101.50	6.79	
<i>Shpenzimet</i>	874,506.96 €	894,282.03 €	19,775.07 €	2.3%
<i>Pagat</i>	546,329.00 €	545,948.70 €	- 380.30 €	-0.1%
<i>Rryma elektrike</i>	171,273.90 €	181,087.01 €	9,813.11 €	5.7%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	16,501.27 €	26,949.38 €	10,448.11 €	63.3%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	42,788.46 €	33,180.22 €	- 9,608.24 €	-22.5%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	11,268.29 €	20,775.36 €	9,507.07 €	84.4%
<i>Shpen. E taksave</i>	23,040.40 €	22,981.48 €	- 58.92 €	-0.3%
<i>Kemikalet</i>	5,539.68 €	10,402.42 €	4,862.74 €	87.8%
<i>Shpenzimet tjera</i>	57,765.96 €	52,957.46 €	- 4,808.50 €	-8.3%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	3,975,410	4,321,426	346,016	8.7%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	73.14	69.73	(3.42)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.07	1.41	0.34	
<i>Mbulimi operativ-€</i>	61,679.58 €	368,321.27 €	306,641.69 €	

6.2 NJËSIA OPERATIVE- SUHAREKË

• NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM2-2023	TM3-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	1,087,135	1,321,810	234,675	21.6%
<i>Faturimi m3</i>	270,944	363,030	92,086	34.0%
<i>Faturimi nga uji €</i>	187,358.62 €	236,283.95 €	48,925.33 €	26.1%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	1,716.58 €	1,863.52 €	146.94 €	8.6%
<i>Faturimi Total €</i>	189,075.20 €	238,147.47 €	49,072.27 €	26.0%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	150,818.38 €	197,457.49 €	46,639.11 €	30.9%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	1,679.10 €	1,934.57 €	255.47 €	15.2%
<i>Inkasimi Total €</i>	152,497.48 €	199,392.06 €	46,894.58 €	30.8%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	10,158	10,396	238	2.3%
<i>% e inkasimit</i>	80.50	83.57	3.07	
<i>Shpenzimet</i>	125,684.36 €	147,115.78 €	21,431.42 €	17.1%
<i>Pagat</i>	71,572.20 €	75,107.39 €	3,535.19 €	4.9%
<i>Rryma elektrike</i>	40,263.63 €	50,233.08 €	9,969.45 €	24.8%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	2,590.21 €	2,537.60 €	- 52.61 €	-2.0%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	5,955.91 €	6,971.78 €	1,015.87 €	17.1%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	772.89 €	4,307.00 €	3,534.11 €	457.3%
<i>Shpen. E taksave</i>	2,277.16 €	2,574.56 €	297.40 €	13.1%
<i>Kemikalet</i>	- €	2,671.92 €	2,671.92 €	#DIV/0!
<i>Shpenzimet tjera</i>	2,252.36 €	2,712.45 €	460.09 €	20.4%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	816,191	958,780	142,589	17.5%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	75.08	72.54	(2.54)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.21	1.36	0.14	
<i>Mbulimi operativ-€</i>	26,813.12 €	52,276.28 €	25,463	95.0%

6.3 NJËSIA OPERATIVE- DRAGASH

• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

MUAJI	TM2-2023	TM3-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	247,247	259,183	11,936	4.8%
<i>Faturimi m3</i>	37,311	63,373	26,062	69.9%
<i>Faturimi nga uji €</i>	26,295.64 €	45,120.99 €	18,825.35 €	71.6%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	70.00 €	185.00 €	115.00 €	164.3%
<i>Faturimi Total €</i>	26,366	45,306	18,940	71.8%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	26,166.69 €	38,694.51 €	12,527.82 €	47.9%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	70.00 €	332.05 €	262.05 €	374.4%
<i>Inkasimi Total €</i>	26,236.69 €	39,026.56 €	12,789.87 €	48.7%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1,636	1,645	9	0.6%
<i>% e inkasimit</i>	99.51	85.76	(13.75)	
<i>Shpenzimet</i>	38,886.42 €	34,745.84 €	- 4,140.58 €	-10.6%
<i>Pagat</i>	31,110.19 €	30,832.54 €	- 277.65 €	-0.9%
<i>Rryma elektrike</i>	1,318.99 €	1,026.25 €	- 292.74 €	-22.2%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	362.39 €	608.51 €	246.12 €	67.9%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	1,890.36 €	724.10 €	- 1,166.26 €	-61.7%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	1,108.29 €	167.54 €	- 940.75 €	-84.9%
<i>Shpen. E taksave</i>	35.35 €	48.72 €	13.37 €	37.8%
<i>Kemikalet</i>	2,574.00 €	858.00 €	- 1,716.00 €	-66.7%
<i>Shpenzimet tjera</i>	486.85 €	480.18 €	- 6.67 €	-1.4%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	209,936	195,810	(14,126)	-6.7%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	84.91	75.55	(9.36)	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.67	1.12	0.45	66.5%
<i>Mbulimi operativ-€</i>	- 12,649.73 €	4,280.72 €	16,930	

6.4 NJËSIA OPERATIVE- MALISHEVË

• NJËSIA PUNUESE - MALISHEVË

MUAJI	TM2-2023	TM3-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	710,935	690,625	(20,310)	-2.9%
<i>Faturimi m3</i>	140,280	165,926	25,646	18.3%
<i>Faturimi nga uji €</i>	101,067.68 €	115,076.86 €	14,009.18 €	13.9%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	2,134.08 €	5,954.00 €	3,819.92 €	179.0%
<i>Faturimi Total €</i>	103,202	121,031	17,829	17.3%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	89,282.89 €	128,786.09 €	39,503.20 €	44.2%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	2,136.48 €	5,894.93 €	3,758.45 €	175.9%
<i>Inkasimi Total €</i>	91,419.37 €	134,681.02 €	43,261.65 €	47.3%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	6,044	6,112	68	1.1%
<i>% e inkasimit</i>	88.34	111.91	23.57	
<i>Shpenzimet</i>	111,980.83 €	111,685.50 €	- 295.33 €	-0.3%
<i>Pagat</i>	63,601.42 €	65,355.89 €	1,754.47 €	2.8%
<i>Rryma elektrike</i>	35,356.03 €	35,293.92 €	- 62.11 €	-0.2%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	1,434.83 €	1,648.79 €	213.96 €	14.9%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	7,249.23 €	4,414.01 €	- 2,835.22 €	-39.1%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	987.51 €	1,442.30 €	454.79 €	46.1%
<i>Shpen. E taksave</i>	129.70 €	932.65 €	802.95 €	619.1%
<i>Kemikalet</i>	2,251.53 €	1,743.59 €	- 507.94 €	-22.6%
<i>Shpenzimet tjera</i>	970.58 €	854.35 €	- 116.23 €	-12.0%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	570,655	524,699	(45,956)	-8.1%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	80.27	75.97	(4.29)	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.82	1.21	0.39	
<i>Mbulimi operativ-€</i>	- 20,561.46 €	22,995.52 €	43,557	

6.5 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN

• HIDROREGJIONI JUGOR

MUAJI	TM2-2023	TM3-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	7,480,502	8,469,371	988,869	13.2%
<i>Faturimi m3</i>	1,908,310	2,468,656	560,346	29.4%
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,297,938.64 €	1,635,576.24 €	337,638	26.0%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	8,819.74 €	13,762.89 €	4,943	56.0%
<i>Faturimi Total €</i>	1,306,758.38 €	1,649,339.13 €	342,581	26.2%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	1,197,492.80 €	1,622,622.72 €	425,130	35.5%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	8,847.28 €	13,080.22 €	4,233	47.8%
<i>Inkasimi Total €</i>	1,206,340.08 €	1,635,702.94 €	429,363	35.6%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	57,565	58,270	705	1.2%
<i>% e inkasimit</i>	92.26	99.21	6.95	7.5%
<i>Shpenzimet</i>	1,151,058.57 €	1,187,829.15 €	36,770.58 €	3.2%
<i>Pagat</i>	712,612.81 €	717,244.52 €	4,631.71 €	0.6%
<i>Rryma elektrike</i>	248,212.55 €	267,640.26 €	19,427.71 €	7.8%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	20,888.70 €	31,744.28 €	10,855.58 €	52.0%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	57,883.96 €	45,290.11 €	- 12,593.85 €	-21.8%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	14,136.98 €	26,692.20 €	12,555.22 €	88.8%
<i>Shpen. E taksave</i>	25,482.61 €	26,537.41 €	1,054.80 €	4.1%
<i>Kemikalet</i>	10,365.21 €	15,675.93 €	5,310.72 €	51.2%
<i>Shpenzimet tjera</i>	61,475.75 €	57,004.44 €	- 4,471.31 €	-7.3%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	5,572,192	6,000,715	428,523	7.7%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	74.49	70.85	(3.64)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.05	1.38	0.33	
<i>Mbulimi operativ-€</i>	55,281.51 €	447,873.79 €	392,592	

6.5 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A - PRIZREN

• HIDROREGJIONI JUGOR

MUAJI	TM3-2022	TM3-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	5,018,661	8,469,371	3,450,710	68.8%
<i>Faturimi m3</i>	2,336,480	2,468,656	132,176	5.7%
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,520,804.41 €	1,635,576.24 €	114,772	7.5%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	16,819.32 €	13,762.89 €	(3,056)	-18.2%
<i>Faturimi Total €</i>	1,537,623.73 €	1,649,339.13 €	111,715	7.3%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	1,521,854.25 €	1,622,622.72 €	100,768	6.6%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	17,209.54 €	13,080.22 €	(4,129)	-24.0%
<i>Inkasimi Total €</i>	1,539,063.79 €	1,635,702.94 €	96,639	6.3%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	55,929	58,270	2,341	4.2%
<i>% e inkasimit</i>	100.07	99.21	(0.86)	-0.9%
<i>Shpenzimet</i>	1,038,590.00 €	1,187,829.15 €	149,239.15 €	14.4%
<i>Pagat</i>	623,674.00 €	717,244.52 €	93,570.52 €	15.0%
<i>Rryma elektrike</i>	225,051.00 €	267,640.26 €	42,589.26 €	18.9%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	35,852.00 €	31,744.28 €	- 4,107.72 €	-11.5%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	36,785.00 €	45,290.11 €	8,505.11 €	23.1%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	14,221.00 €	26,692.20 €	12,471.20 €	87.7%
<i>Shpen. E taksave</i>	29,586.00 €	26,537.41 €	- 3,048.59 €	-10.3%
<i>Kemikalet</i>	12,869.00 €	15,675.93 €	2,806.93 €	21.8%
<i>Shpenzimet tjera</i>	60,552.00 €	57,004.44 €	- 3,547.56 €	-5.9%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,682,181	6,000,715	3,318,534	123.7%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	53.44	70.85	17.41	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.48	1.38	(0.10)	
<i>Mbulimi operativ-€</i>	500,473.79 €	447,873.79 €	(52,600)	

6.6 REALIZIMI I CAQEVE- TM2-2023

• HIDROREGJIONI JUGOR

MUAJI	PB- TM3-2023	TM3-2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	5,526,013	8,469,371	2,943,358	53.3%
<i>Faturimi m3</i>	2,590,411	2,468,656	(121,755)	-4.7%
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,611,527.30 €	1,635,576.24 €	24,049	1.5%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	4,110.00 €	13,762.89 €	9,653	234.9%
<i>Faturimi Total €</i>	1,615,637.30 €	1,649,339.13 €	33,702	2.1%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	1,516,369.95 €	1,622,622.72 €	106,253	7.0%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	4,110.00 €	13,080.22 €	8,970	218.3%
<i>Inkasimi Total €</i>	1,520,479.95 €	1,635,702.94 €	115,223	7.6%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	58,140	57,565	(575)	-1.0%
<i>% e inkasimit</i>	94.10	99.21	5.11	5.4%
<i>Shpenzimet</i>	1,220,055.46 €	1,187,829.15 €	- 32,226.31 €	-2.6%
<i>Pagat</i>	697,620.27 €	717,244.52 €	19,624.25 €	2.8%
<i>Rryma elektrike</i>	276,572.23 €	267,640.26 €	- 8,931.97 €	-3.2%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	23,518.71 €	31,744.28 €	8,225.57 €	35.0%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	83,622.89 €	45,290.11 €	- 38,332.78 €	-45.8%
<i>Miremb, e automjeteve</i>	20,049.51 €	26,692.20 €	6,642.69 €	33.1%
<i>Shpen. E taksave</i>	26,340.51 €	26,537.41 €	196.90 €	0.7%
<i>Kemikalet</i>	9,792.89 €	15,675.93 €	5,883.04 €	60.1%
<i>Shpenzimet tjera</i>	82,538.45 €	57,004.44 €	- 25,534.01 €	-30.9%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,935,602	6,000,715	3,065,113	104.4%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	53.12	70.85	17.73	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.25	1.38	0.13	
<i>Mbulimi operativ-€</i>	300,424.49 €	447,873.79 €	147,449	

6.7 TRANSAKSIONET KRYESORE- TM1-2023

Tabela Nr.30 - 10 pagesat me te mëdha nga Hidroregjioni Jugor për Operatoret TM3 2023

Data	Nr. i dokumentit	Nr. I furnitorit	Emri I operatorit	Shuma
7/11/2023	NLB-P-00029153	FUR-01016	NPT Xerxa fat.106/06	40,346.70
8/2/2023	BPBPZNPOS-006226	FUR-01661	Pag.fat.36/2023 K-ING sh.p.k.	38,038.74
7/5/2023	NLB-P-00029139	FUR-01373	Muratori sh.p.k. fat.04/23	32,429.61
9/22/2023	NLB-P-00029673	FUR-01039	KEK - Bunari I	27,964.00
8/21/2023	NLB-P-00029500	FUR-01039	KEK - Bunari I	27,449.98
7/20/2023	NLB-P-00029244	FUR-01039	KEK - Bunari I	26,201.36
8/23/2023	NLB-P-00029513	FUR-01834	Delfin Auto SH.P.K. fat.64/23	16,480.00
8/23/2023	NLB-P-00029514	FUR-01834	Delfin Auto SH.P.K. fat.63/23	16,480.00
8/23/2023	NLB-P-00029515	FUR-01834	Delfin Auto SH.P.K. fat.62/23	16,480.00
9/4/2023	NLB-P-00029583	FUR-01834	Delfin Auto SH.P.K. fat.60/23	16,480.00
TOTAL				258,350.39

Tabela Nr.31 - 10 pagesat me te mëdha ndaj Hidroregjioni Jugor për TM3 2023

Data	Kons	Emri I konsumatorit	Banka	Kategoria	Shuma
12.09.2023	KONS-0029761	Progres SHpk - I.E. FIJEVE SINTETIKE	ProCreditBanka	INSTITUCIO	15,093.00
11.07.2023	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	12,666.00
09.08.2023	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	11,294.30
28.08.2023	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	SHTEPI..F	11,294.30
21.07.2023	KONS-0026307	NPN Renelual Tahiri	ARKA-GEONITA	LOKALET	10,030.01
21.07.2023	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	8,221.39
21.07.2023	KONS-0026307	NPN Renelual Tahiri	NLB Banka	INSTITUCIO	5,634.36
26.09.2023	KONS-0029809	Sh.K.K Qendra e paraburgimit - Prizren	Banka per Bisnes	LOKALET	4,252.58
07.07.2023	KONS-0059600	Galeria Shopping Mall SH P K	Teb Banka	SHTEPI..Q	3,313.17
29.08.2023	KONS-0029704	N.T.SH.P."EURO FOOD"sh.p.k.	ARKA-HASIME	INSTITUCIO	2,403.76
TOTAL					84,202.87

VII. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

7.1 KOMENTET KRYESORE

PËRFAQËSIMI NË GJKATA KORRIK – SHTATOR 2023

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Ndërmjetësim	Totali
Korrik	2	1	/	3	6
Gusht	/	/	/	/	/
Shtator	2	1	1	1	5
Totali	4	2	1	4	11

ARDHJET NGA GJKATA DHE INSTITUCIONET TJERA KORRIK – SHTATOR 2023

	Korrik	Gusht	Shtator	Totali
Aktvendime me aprovime të pjesshme	1	1	1	3
Refuzimet	/	/	/	/
Me përfaqësues	/	/	/	/
Aktvendime pro kompanisë	1	/	1	2
Aktvendime kundër kompanisë	3	/	/	3
Aktgjykime të Kallëzimeve Penale në favor të kompanisë	1	/	/	1
Aktgjykime të Kallëzimeve Penale kundër kompanisë	1	/	/	1
Caktim i përfaqësuesit të përkohshëm	/	2	1	3
Thirrje për seanca gjyqësore	/	1	1	2
Kallëzime penale	/	3	/	3
Hedhet kallëzimi penal	/	/	1	1
Kallëzime Penale të zgjidhura me ndërmjetësim	/	8	/	8
Padi kundër kompanisë	/	1	1	2
Përgjigje ne Padi	/	1	1	2
VENDIME NGA APELI	/	/	/	/
Aktgjykimi në favor të kompanisë	/	/	/	/
Aktgjykim kundër kompanisë	/	1	/	1
Aktvendime kundër kompanisë	/	2	/	2
GJKATA KOMERCIALE E KOSOVES				
Aktvendime në favor të kompanisë	2	/	/	2
Aktvendime në kundër kompanisë	2	/	1	3
Ftesa për seanca gjyqësore	/	/	/	/
Ankesa kundër kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime ku lëndët dërgohen në gjykatën komerciale	/	/	/	/
E.nr.	5	/	/	5
Konkluzione të ndryshme E.nr.	4	/	/	4

Punët tjera nga Zyra Ligjore

- Kemi përgatitur Autorizime të ndryshme për përfaqësime dhe për punë tjera;
- Kemi pranuar konsumatorë dhe të njëjtit i kemi njoftuar dhe udhëzuar për procedurën përmbartimore dhe hapat që të njëjtit duhet ti ndër marrin për pagesën e borxheve që kanë ndaj Kompanisë;
- Kemi qenë të angazhuar edhe në takime zyrtare me Përmbartuesit Privat, ku janë diskutuar problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë punës;
- E kemi përfaqësuar Kompaninë në prokurori;
- I kemi bërë përgatitjet e nevojshme për seancat e ardhshme Gjyqësore;
- I kemi evidentuar hyrjet dhe daljet e lëndëve nga Kompania;
- Kemi qenë të kyçur edhe në Komisione për shqyrtimin e Ankesave nga aplikantët në Konkurse pune, ku i kemi udhëhequr të gjitha procedurat ligjore;
- Kemi marrë pjesë në hapjen e dokumenteve të kandidatëve për sekretar/e të Kompanisë;
- E kemi rishpallur Konkursin për vendin e punës Sekretar/e të Kompanisë;
- Kemi mbajtur Procesverbal në Komisionin e Auditimit;
- Nga përmbartuesit privat janë inkasuar mjete në lartësinë prej **19,637.34** euro;
- ***Kemi mungesë stafi, Zyra Ligjore nuk ekziston fare sipas Rregullores së fundit mbi Sistematizimin e Vendeve të Punës, nuk ka Udhëheqës të Zyrës Ligjore, nuk ka Asistente Juridike për kryerjen e punëve teknike;***
- ***Zyra e Burimeve Njerëzore nuk ka Shef (Udhëheqës) por e njëjta menagjohet vetëm nga një Zyrtare e Burimeve Njerëzore që është tepër pak ngase për afro 350 punonjës një Zyrtare nuk ka gjasa që ta menagjoj as për së afërmi volumin e punëve që duhet kryer;***
- ***Ri aktualizohet sërish çështja e problemeve me mungesën e automjeteve për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës nga administrata dhe resurset humane, ku kërkojmë që urgjentisht të rregullohet kjo çështje, në të kundërtën do të ketë pasoja të drejtpërdrejta dhe të shpejta, dhe për pasojat eventuale ky departament nuk do të mbajë përgjegjësi pasi që në vazhdimësi është kërkuar dhe insistuar që problemi në fjalë të zgjidhet, mirëpo në vazhdimësi ky problem është injoruar ngase definitivisht kemi të bëjmë me individ që nuk kuptojnë se si caktohen prioritetet e punëve në institucione;***
- ***Lëndëve që kërcënojnë kompaninë i janë shtuar edhe tri Padi tjera, ku dy prej tyre janë Padi nga Marrëdhënia e punës padi këto të ushtruara nga stafi i Kompanisë, dhe një Padi kontestim i borxhit nga ana e konsumatorit;***
- Kemi përgatitur Propozime për Përmbartim, Përgjigje në Prapësime, Konstatime, Vendime, Autorizime, Marrëveshje, Kërkesa, Kallëzime Penale, plotësime të Kallëzimeve Penale, Kërkesa, Përgjigje në Kërkesa, Ankesa, Njoftime, Interpretime të Ligjeve, Njoftime, si dhe shkresa tjera të cilat i kemi adresuar tek institucionet e ndryshme;
- E kemi përfaqësuar Kompaninë në gjykata për lëndë civile dhe penale për të gjitha ftesat nga gjykatat, e kemi përfaqësuar kompaninë në Prokurori në lëndët me ndërmjetësime, kemi dhënë edhe Njoftime, plotësime të Kallëzimeve Penale sipas Kërkesave nga Prokuroria;

- Kemi kryer edhe punë tjera që i përkasin detyrave të Zyrës Ligjore si dhe kërkesave shtesë, të gjitha këto sipas dinamikës së paraparë në kohë dhe cilësi.

Aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për TM/3, 2023 – Prizren

- ❖ Gjatë tremujorit të tretë (3) janë realizuar vizita/kontrolla të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cialt sigurohen nga kujdestaret – roje 24 h në pikat e Prizrenit:

- **40 BURIMET**
- **MULLIRI I VJETËR**
- **SHPATI**
- **BUNARI 1**
- **DREJTORIA**
- **KOAGULATORET**

❖ *Gjatë tremujorit të tretë (3), janë realizuar këto aktivitete:*

- Janë përpiluar raportet për muajin korrik, gusht dhe shtator/2023 si dhe raporti i TM/2 – 2023.
- Gjithashtu janë përpiluar edhe oraret e punës për muajin gusht, shtator dhe tetor/2023, ku edhe është bërë shpërndarja e tyre në të gjitha objektet të cilat kujdestarohen gjatë 24h në Prizren.
- Gjatë ç’do fund jave kam pranuar Njoftimin, se kush do të jetë kujdestar gjatë gjithë javës në sektorin Operativ, dhe më pastaj është bërë shpërndarja e tyre në çdo objekt ku kujdestarohet gjatë 24 h nga Rojet.
- Si ç’do muaj edhe gjatë këtij tremujori të tretë TM/3, janë bërë llogaritjet e pagave për ç’do punëtor Kujdestar – Roje sipas angazhimeve të tyre që kanë treguar në vazhdimësi.
- Gjatë këtij tremujori të tretë TM-3, është bërë një organizim më i madhe rreth pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve në njësinë punuese në Prizren dhe objekteve në fshatrat për rreth, ku si fillim si sektor i sigurisë jemi furnizuar me disa vegla pune të nevojshme për pastrimin dhe mirembajtjen e objekteve:
 - 2 Trimerë, të cilat funksionojnë me anë të karburantit Benzinë,
 - 4 Kosa me bishtë,
 - 2 Këmesa me bishtë,
 - 2 Tërfurka me bishtë,
 - 4 Grabuja me bishtë,
 - 1 Tub me tel për kositje,
 - 4 Mprehësa për Kosa dhe,
 - 20 copë me nga 100ml vaj 2-T, për Trimerë.

- Si fillim është pastruar objekti i stacionit të pompimit dhe klorifikimit në fshatin Arbanas (Sërbice), në mënyr vullnetare nga ishe punëtori përgjegjës i objektit në fjale, tani me pozite kujdestar roje në Prizren.
- Është pastruar objekti i stacionit të pompave dhe klorifikimit në fshatin Novakë, ku pastrimi i këtij objekti është bërë me ndihmën e punëtorëve të operatives dhe atyre të elektrikistave, duke vazhduar me radhe në objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret roje në Prizren, në pamundësi të vazhdojmë tutje, në munges të automjetit zyrtar.
- Gjatë muajit Korrik janë dorëzuar 21 fatura në zyrën e z.Hysni Ahmetit, fatura këto të lëshuara nga punëtorët kujdestar roje gjatë muajit Qershor në objektin “Mullini”, ku kompania:
 - ✓ Eko-regjioni gjatë muajit Qershor/2023 është furnizuar nëntëmbëdhjetë here (19), me nga tetë ton (8 m³) dhe,
 - ✓ kompani “Shërbimi” është furnizuar vetëm dy here (2), me nga dhjetë ton (10 m³).
- Në mëngjesin e së martës të datës 25.07.2023, kemi marrur informacion se zyrat e Administratës së Suharekës gjatë natës ishin shkallmuar.
- Sëbashku me zyrtarin për Siguri dhe Shëndet në punë, kemi filluar ti kontrollojmë kamerat e sigurisë dhe kemi vërejtur se personi i cili ka kryer aktin, ka tentuar të hyjë nga Dera Kryesore e objektit të Administratës, rreth orës 22;14 e 31 sekonda të datës 24.07.2023 (ditë e hëne), por kur ka arritur te dera, ka vërejtur kamerën e sigurisë e cila është vendosur në koridorin e parë, sipër Aparatit për regjistrimin e hyrjeve dhe daljeve në punë të punëtorëve.
- Rreth orës 11;15 sëbashku me zyrtarin për Siguri dhe Shëndet në punë, kemi shkuar në Suharekë, për ta parë për së afërmi ngjarjen e cila kishte ndodhur në mbrëmjen e së hënës. Aty pamë se Ai kishte hyrë nga prapa, ku e kishte shkallmuar dritaren dhe kishte hyrë brenda në objekt, e më pastaj për ti shkallmuar me rend të gjitha dyert e zyrëve.
- Sipas Menaxherit të Njesisë së Suharekës, personi i cili është futur brenda në objekt, kishte për qëllim të marrë Para, ku edhe e kishte shkallmuar një mini-kasafort, por për fat të mirë nuk kishte asnjë Para në të, pasi që sipas detyrave të punës së porto – arkës, gjatë çdo përfundimi të orarit të punës bëhet dorëzimi i të hollave në Bankën përkatëse.
- “Ai” kishte marru një komplet të veglave të punës dhe një Lap Top, i cili nuk ishte në funksion sipas Menaxherit të Njesisë së Suharekës.
- Për këtë ngjarje është njoftuar Policia, ku edhe kanë ardhur në vendin e ngjarjes dhe kanë marrur gjurmët e gishtrinjëve dhe kanë paraqitur rastin në Prokurorin e Shtetit, për të vazhduar më tutje rreth zbardhjes së rastit.
- Gjatë këtij tremujori si sektori i sigurisë jemi furnizuar me paisje Higjienike - për objekte. Paisjet higjienike janë shpërndarë në mënyr proporcionale në të gjitha ato objekte të cilat sigurohen nga Kujdestaret Roje në Njesisë punuese në Prizren.
- Është përpiluar Njoftimi rreth mbarëvajtjes së punës në objektin “Shpati”, gjatë muajit gusht, ku edhe në mënyr elektronike janë njoftuar Sekretarja e kompanisë dhe Menaxheri i Administratës.
- Gjatë muajit gusht çdo kujdestar roje ka nënshkruar Aneks Kontratën, për ngritjen e një pike të koeficientit të pages, ku në fund të muajit të gjitha Aneks Kontratat janë dorëzuar te Zyrtarja për burime njerëzore.
- Në fillim të muajit shtator Sektori i sigurisë – të gjithë kujdestaret roje janë furnizuar me nga një Maic (uniform).
- Gjatë këtij muaji kam qenë Antar në komision për hapjen e Tenderit “Shërbim me internet dhe DTV në pikat e KRU “Hidroregjioni Jugor”Sh.A.Prizren

- Po ashtu me datë 22.09.2023, përsëri kam qenë Antar në komisioni për hapjen e Ritenderit “Furnizim me kompjuter për zyret e KRU” Hidroregjionit Jugor” Sh.A. Prizren.
- Pas kërkesës së Zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë, është përpiluar Lista me emrat e atyre punëtorve kujdestar roje, të cilët punojnë në ato objektet ku kanë për detyrë përcjelljen për mbarëvajtjen e klorit, po ashtu në atë listë është spjeguar më qartë se në ato objekte mund të ketë her pas here ndërrime rrotative të kujdestarëve roje dhe mund të ndryshojnë edhe emrat e atyre të shënuar në atë listë që ju është dërguar Zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë.
- Gjatë këtij muaji kemi bërë edhe disa Analiza të ndryshme, me qëllim që Kujdestaret Roje mos të krijojnë pa prekshmëri në vendin se ku ata për arsye të interesave personale të punojnë (objekt), dhe si ndryshim është paraparë të bëhen ndërrime rrotative të Kujdestarëve Roje, nga një objekt në tjetrin objekt. Ku përveq mos varësisë së objektit, Ata të bëjnë një Rifreskim të punës (pas ndryshimit të objektit) me qëllim që të ngritet edhe më lartë niveli i sigurisë në objekte.
- Gjatë këtij tremujorit të tretë TM-3, janë bërë gjithësejë trembëdhjetë (13) kërkesa nga ana e Kujdestarëve Roje për shfrytëzimin e pushimit vjetor gjatë muajëve gusht, shtator dhe tetor/2023. Ku këto kërkesa janë aprovuar nga ana ime dhe të njejtat janë dërguar në Zyren për burime njerëzore.

Aktivite e Zyrtarit për Siguri dhe Shendetin në Punë për periudhen TM/3 të vitit 2023.

- Gjatë periudhes TM/3 janë realizuar vizita në objektet e Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, janë vizituar të gjitha objektet në njesin punuse në Prizrenit, siq janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatorët”, objektet te “Mulliri i vjetër”, objektet e “40 Burimeve I”, objekti dhe “40 Burimeve II” ku janë kontrolluar gjendja e tyre, pastertia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapsira për rrethë objekteve.
- Gjatë kesaj periudhe të TM/3 kam bërë shkresë zyrtare për të gjithë Udhëheqësit dhe Menaxherat e Njesive Punuse të “Hidroregjionit Jugor” të respektojnë masat e mbrojtjes të sigurisë në punë si dhe bartjen e uniformave gjatë orarit të punës, njeherit janë paralajmruar dote të sanksioneve sipas rregullores së mbrendshme.
- Gjatë TM/3 jamë emruar anëtarë i komisionit për të bërë kategorizimin e punëtorve që duhet përdorur mjete mbrojtëse në punë si dhe duhet të përpilohet lista e punëtorve që kanë nevojë për mbrojtjen e shendet gjatë procesit të punës.
- Gjatë kesaj periudhe është mbajtur trajnimi në UPZ nga komisioni rregullativ e prokurimit public lidhur me menaxhimin dhe vlersimin e performancës së kontratave për mes e-prokurimit, dhe gjatë trajnimit janë specifikuar dhe diskutuar tamat për menaxhimin e kontratave derinë në perfundim të procesit.
- Me kërkesën e Zyrtares për Burime Njerëzore në këtë TM/3 është nxjerrur raporti i vijshmerisë në punë nga data 23 gusht deri me datën 04 shtator për punëtorin Din Osmanollaj dhe kjo kërkesë është përcjellur sekretares së kompanisë dhe kryetarit të komisionit disiplinor.
- Gjatë TM/3 përkatshisht në muajit shtator është takuar komisioni Disiplinor dhe ka inicuar procedurën për komision disiplinor ndaj punëtorit Din Osmanollaj i cili nuk ka vijuar punën pas pushimit pa pagesë, njeherit komisioni ka nxjerrur rekomandimin për punëtorin Din Osmanollaj dhe

ka propozuar kryeshefit ekzekutiv të zhvillon procedurat e metutjeshme për mos mosparaqitjen në vendin e punës.

- Gjatë këtij TM/3 është bërë inspektim në njesin punuse në Suharekë janë inspektuar punëtorët e shërbimit operativ dhe janë kontrolluar këto objekte: Objekti i Drejtorisë (Administrata), Pusi i Atit, Rezervaret në Baçevcë, dhe shërbimi operativ gjatë realizimit të punimeve në fshatin Samadrazh.
- Pas inspektimit të puntorëve dhe të objekteve në njesin punuse në Suharekë janë dhënë edhe rekomandimet për menaxhmentin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve me mundsinë për ndryshimin e gjendjes në këtë njesi punuse.
- Në këtë TM/3 janë inspektuar punëtorët e njesisë punuse në Malishevë, në Banjë si dhe është inspektuar shërbimi operativ në fshatin Bellanicë ku ishte duke u bërë eliminimi i defektit në rrjetin e ujësjellësit.
- Pas inspektimit të puntorëve dhe të objekteve të njesin punuse në Malishevë janë dhënë edhe rekomandimet për menaxhmentin me mundsinë për ndryshimin e gjendjes në këtë njesi punuse.
- Gjatë periudhës të TM/3 janë inspektuar punëtorët e njesisë punuse në Dragash ku janë inspektuar punëtorët gjatë dedektimit të rrjetit të ujësjellësit, puntorët e shërbimit operativ, kujdestarët në objektin të filtratit si dhe zyret e Hidroregjionit në Dragash.
- Pas inspektimit të puntorëve dhe të objekteve të njesin punuse në Dragash janë dhënë edhe rekomandimet për menaxhmentin si dhe për mirmbajtjen e objekteve për higjienën jo të mirë në këtë njesi punuse.
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë inspektimet në njesin punuse në Prizren dhe kemi filluar me inspektimet e shërbimit operativ, inspektimet e kanalizuesve, inspektimet e kontrolles, inspektimet e lexuesve, servisimi i ujmatësave, inspektimet kujdestarët – roja të 40 burimit, të mullirëve, në Shadervan, inspektimet të kuogulatorëve, dhe inspektimet të impijantit për trajtimin e ujrave të ndotura.
- Nga këto inspektime në njesin punuse në Prizren janë rekomanduar menaxheret ose udhëheqësit e shërbimeve përkatëse të kenë kujdes të shtuar lidhur me përdorimin e uniformave dhe masat e mbrojtjes në punën.
- Për të gjitha inspektimet që janë bërë nëpunësit punuse janë realizuar në prezencën e menaxherëve ose udhëheqësve të shërbimeve përkatëse së bashku me ZSSH dhe me menaxherin e kontratës për furnizim me uniforma të punës.
- Për të gjitha inspektimet në Kompaninë e "Hidroregjionin Jugor" jemi duke e pregaditur edhe raportin për se cilën njesi lidhur me rrespektimin e masave mbrojtjes në punë, bartja e uniformave në vendin e punës, gjendjen e objekteve si dhe do të jepin rekomandimet për të gjitha shërbimet nga Zyrtari për Siguri dhe Shëndet në Punë.
- Gjatë kësaj periudhe TM/3 kam dorëzuar kërkesë zyrtare për zhvillimin e procedurave tenderuse për servisimin e aparateve kundër zjarrit në Hidroregjionin Jugor në Prizren së bashku me njesin punuse në Suharekë, Malishevë, dhe Dragashë.
- Gjatë kësaj periudhe të TM/3 Kompania e Hidroregjionit ka bërë DDD e objekteve të ITUN në dy faza për mbrojtjen e paisjeve elektrike nga brejtësit të ndyshëm si dhe fazën e dytë dezinfektimi dhe dezinfektimi i objekteve si masat mbrojtëse për largimin e zvarranikëve të ndyshëm etj., njëherit pas përfundimit të DDD është punuar edhe raporti për zhvillimet të punimeve, ku është nënshkruar nga Menaxheri i Departamentit të ITUN dhe nga Zyrtari për Siguri dhe Shëndet në Punë.
- Gjatë TM/3 jam emëruar menaxher i projektit për furnizim me pesë automjete të pa shfrytëzuar për transport të mallrave (Corgo), ku kam nënshkruar kontratën dhe i kam bërë kërkesë sipas

procedurave operatorit ekonomik për të nenshkruart kontraten për vazhduar procedurat për furnizim, si dhe jam emruar mbikqyrës i drejtperdrejt i menaxherit të kontrates së projektit për “Furnizim me paisje për “Dezinfektim dhe pjesë rezerve për kolor gas dhe Hipoklorit Natriumi”.

- Gjatë kesaj periudhe është dorzuar edhe raporti për inspektimin lidhur me plaqkitjen dhe demolimin e zyreve të HRJ në njesin punuse në Suharekë ku është kerkuar nga menaxheri i njesisë punuse që rojtari i objektit M.J për daten dhe kohen e cekur të paraqet një deklarat me shkrim për periudhen derisa ka qenë në orar të punës.
- Gjatë periudhes të tremujorit të tret kemi pasur edhe defekte të rrjetit te kamerave për siguri të cilat janë sanuar nga zyrtari I IT, ose edhe nga mungesa e rrymes, por ende janë jashtë perdorimit për shkak defektit kamer e objekti i Komores së Re.
- Në këtë TM/3 është berë vëzhgimit dhe monitorimi i kamerave të sigurisë pran zyres në objektin e Hidroregjionit nepër të gjitha vendet ku kemi kamerat e siguris ka shkuar në rregullë.
- Gjatë kesaj periudhe është berë vezhgimi dhe monitorimi i kamerave të sigurisë në njesin punuse në Suharekë, dhe ku proqesi i vejushmeris të punëtorve ka shkuar në rregullë.
- Në TM/3 është berë vëzhgimi dhe monitorimi i kamerave të sigurisë në njesin punuse në Malishevë ku proqesi i vejushmeris të punëtorve ka shkuar në rregullë.
- Periudhen e TM/3 është vëzhguar dhe berë monitorimi i kamerave të sigurisë në njesin punuse në Dragash ku proqesi i vejushmeris të punëtorve ka shkuar në rregullë.
- Gjatë kesaj periudhe të TM/3 kemi bërë kontrollimi i punëtorëve të sherbimit opertaiv për kujdesin në punë dhe respektimin e Ligjit për Sigurin dhe Shendetin në Punë, duke realizuar punime në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujesjellësit dhe të kanalizimit nëpër disa vende në qytetin e Prizrenit.

Aktivitetet e Zyrës së Burimeve Njerëzore gjatë muajve KORRIK – SHTATOR - 2023

- **Pushimi kalendarik për pushime vjetore për vitin 2023 fillon nga 01.07.2023 dhe përfundon me 30.06.2024, ndërsa për pushim mjekësor është 01.01.2023 deri me 31.12.2023.**

Nr	Llojet e pushimeve	Numri i punonjësve
1	Pushim vjetor	237
2	Pushim mjekësor	50
3	Pushim mjekësor me 50 % te pagës	2
4	Pushim te lehonisë	1
5	Pushim lehonisë për burra	1
6	Pushim pa pagesë	6
7	Pensionim	1
8	Pushim për rast vdekje	2

9	Vërejtje për punëtorët	1
11	Ndërprerje e kontratës me vetë dëshirë	1

- Gjatë tre mujorit 50 (pesëdhjet) punëtorë kanë qenë pushim mjekësor.
- 237 (dyqind e tridhjet e shtat) pushim vjetor.
- Pushim pa pagesë 6 (gjashtë) punëtor.
- Pushim mjekësor me 50 % të pagës dy punëtorë.
- Pushim për rast vdekje 2 (dy) punëtorë
- Një vërejtje për një punëtorë të Kompanisë:

Nr.	DATA	EMRI	MBIEMRI	POZITA E PUNËS	VENDIMI
1	20.09.2023	Dini	Osmanollaj	Teknik i elektros	Vërjetje me shkrim

- Një punëtorë i Kompanisë ka bërë njoftimin nëpërmjet Emailit për shkëputje të kontratës me vete dëshirë:
- Gent Bytyçi – Shef i seksionit GIS me datë 01.09.2023 – Prizren
-
- Gjatë tre mujorit të ttreë 2023 në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit” Hidroregjioni Jugor “Sh.A në Prizren janë pensionuar 1 (një) punëtor;
- Enver Gavazaj – Lexues .në Njësin Punuese Prizren me date: 05.08.2023.
- Është bërë regjistrimi në programin Navizhen të kontratave, pushimeve vjetore, mjekësore, pushimeve pa pagesë, lehonisë për burra, raste vdekje etj.
-
- Janë plotësuar të dhënat shtesë për vitin 2022 të kërkuar nga ARRU për inspektim.
-
- Janë bërë vazhdimet e kontratave të punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qenë në afat të caktuar për një vit dhe gjashtë muaj, sipas vlerësimit të bërë nga ana e udhëheqësve të sektorëve përkatës.
-
- Përgaditja e ankeseve lidhur me ndryshimin në page sipas Vendimit të datës 27.07.2023 të Bordit të Drejtorëve të K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A, në Prizren. Ky Vendim ka fillu të implementohet nga data 01.07.2023.

Konkurset e shpallura te anuluar dhe te rishpallura në periudhën kohore

KORRIK – SHTATOR 2023

Nr	Pozita e punes	Nr I k	Dita e shpalljes se konkursit	Njesija	
1	Rishpallje. Lexues/e në njësin Prizren	1	11.07.2023	PZ	
2	Skretar te Kompanise	1	19.07.2023	PZ	Anuluar me 24.08.2023
3	Rishpallje Zyrtar per Audutim te Brendeshem	1	07.08.2023	PZ	Anuluar me 01.09.2023
4	Rishpallje per Skretar te Kompanise	1	25.08.2023	PZ	
5	Inxhinier/e i/e Hidroteknikës	1	23.08.2023	PZ	Anuluar me 15.09.2023
6	Shef i seksionit komercial	1	23.08.2023	MA	Anuluar 19.09.2023
7	Menaxher i divizionit për prodhim dhe furnizim me ujë	1	07.09.2023	PZ	konkurs I brendshem
8	Rishpallje Udhëheqës i Njësisë Punuese – Ma	1	14.09.2023	MA	
9	Rishpallje Inxhinier/e i/e Hidroteknikës	1	18.09.2023	PZ	
10	Rishpallje Zyrtar per Audutim te Brendeshem	1	18.09.2023	PZ	
11	Rishpallje Shef i seksionit komercial	1	29.09.2023	MA	
12	Arketar/e	1	02.10.2023	SU	

- Sipas kërkesave te punëtorëve kemi leshu vërtetime qe janë pjese e Kompanisë.
- Janë kryer edhe pune tjera sipas kërkesës se Sekretares se Kompanisë dhe Menaxher i administratës dhe burimeve njerëzore
- Dhe pune tjera administrative

7.1 PERSONELI

GJENDJA KORRIK --SHTATOR - 2023

Muajt	Nr.i te punesuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Te tjera
Korrik	324				9 praktikant
Gusht	323			1	9 praktikant
Shtator	323		1		9 praktikant

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE

GJENDJA: KORRIK- SHTATOR- 2023

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	284	31	3	5	323

Numri i Punëtorëve në %	87.9	9.6	0.9	1.5	100
-------------------------	------	-----	-----	-----	------------

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË SHTATOR -2023

GJINIA:	NR	NR. %
FEMRA:	47	14.55
MESHKUJ:	276	85.45
TOTAL	323	100.00

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE – KORRIK- SHTATOR -2023

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
	KUALIFIKIMI							
Kualifikimi	Doktoratë	Mastar	Fakultet	Bucelore	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	2	15	23	40	215	27	1	323
Kualifikimi në %	0.62	4.64	7.12	12.38	66.56	8.36	0.31	100.00

Raport i numrit te punëtorëve, KORRIK - SHTATOR - 2023

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren					Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	DUN	Praktikant	Total			
1	Korrik	330	211	6	21	9	247	34	16	33
2	Gusht	329	208	6	23	9	246	34	16	33
3	Shtator	329	208	6	23	9	246	34	16	33

7.2 ZYRA LIGJORE

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vërejtje
1.	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi.	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2.	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3.	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
4.	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
5.	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
6.	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
7.	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
8.	C.nr. 745/05	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
	05.09.2005		
	C.nr. 68/17 (Nr. i ri)		
	08.10.2015		
9.	C.nr.1902/2019	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
10.	C.nr.251/20	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
11.	C.nr. 1030/20 27.07.2020	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën E apelit në Prishtinë

12.	CP. Nr. 1024/20 19.01.2021	Propozim për përmbarrim	Në Gjykatën Themelore në Prizren
13.	C.nr.363/20	Padi për anulim të Vendimit Nr.930/20	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
14.	C.nr.504/19	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
15.	A.nr.1064/19	Padi për anulim të Vendimit Nr.2707/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ.
16.	C.nr.239/18	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
17.	A.nr. 1361	Padi për shkak të anulimit të vendimit Nr. 2390, dt. 14.07.2023	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm
18.	C.nr. 171/21	Padi për pasurim të pabazë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm
19.	A.nr. 1385	Padi për shkak të anulimit të vendimit Nr. 2410, datë 18.07.2023	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm
20.	C.nr. 1869/19	Padi për shkak të pronësisë në bazë të ndërtimit dhe parashkrimit fitues. Vlera e kontestit 3,100.00 Euro	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm

**PADIT E USHTRUARA NGA
KOMPANIA**

1	J.Sh. F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.313/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovën-Dega në Malishevë
2	N.T.P. Krasniqi,	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

3	Y.Sh., F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.312/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovën-Dega në Malishevë
4	Padi ndaj ATK-së, Prishtinë	A.nr.902/2020	Gjykata Themelore në Prishtinë
5	A.nr. 1648/20, 19.11.2020	Padi për Inicimin e Konfliktit Administrativ	Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ

PROCEDURA PËRMBARIMORE

Korrik – Shtator 2023

	Korrik	Gusht	Shtator	Totali
NJËSIA PUNUESE PRIZREN				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	21	10	49	80
PRAPËSIME	1	1	/	2
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	1	1	/	2
MARRËVESHJE	28	7	9	44
TË PËRFUNDUARA	5	4	8	17
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	3	/	1	4
NJËSIA PUNUESE SUHAREKË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	9	8	9	26
PRAPËSIME	2	2	1	5
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	2	2	1	5
MARRËVESHJE	2	2	1	5
TË PËRFUNDUARA	3	2	2	7
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	1	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/

NJËSIA PUNUESE MALISHEVË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	/	1	1	2
TË PËRFUNDUARA	/	/	/	/
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/
NJËSIA PUNUESE DRAGASH				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	1	/	/	1
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	2	1	/	3
TË PËRFUNDUARA	2	1	1	4
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
LËNDËT E NGELURA PEZULL	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/

VII. DEPARTAMENTI I UN -ITUN

7.1 KOMENTET KRYESORE

7.1.1 FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN

VIII. AUDITIMI I BRENDSHËM

IX. AKTIVITETET E PROKURIMIT – TM3-2023

AKTIVITETET E PROKURIMIT PER VITIN FISKAL 2023

Titulli i kontrates	Kodi intern I procedurës	Data e nenshkrimit	Data e skadimit	Operatori Ekonomik	Vlerat e kontrates	Vërejtje
Shërbim -Kontrollimi Teknik i automjeteve zyrtare të KRU- Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash.	70433702-23-46-2-3-6					Anuluar ne mungese te ofertuesve
Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve në zonën e shërbimit për periudhën janar-dhjetor 2022 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU “Hidroregjioni Jugor” sha	70433702-23-347-2-3-6	24.02.2023	24.03.2023 (Brenda 1 Muaj)	D&D Business Support Center L.L.C.	1,150.00€	
Furnizim me pjese atomjeteve dhe mirmbajtje	70433702-23-17-1-1-1	18.04.2023	13.04.2025	:Grup i Operatorëve Ekonomik Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë Buqa ; AUTO GOMA SH.P.K.	76,892.87€	
Furnizim me material zyrtar administrativ	70433702-23-1895-1-2-1	06.06.2023	05.06.2026	MEDIATEC H & PRINT SH.P.K.	54,294.50€	
Furnizim me naftë dhe Benzinë	70433702-23-3995-1-1-1	12.07.2023	02.07.2026	Petrol Company - SH.P.K.	39.00(me premium)	

Furnizim me tonera per printera.	70433702-23-355-1-3-6	20.06.2023	Brenda 6 muajve	" INFINITT " SH.P.K.	9,541.30€	
Furnizim me material higjienik për nevojat e kompanisë KRU Hidoregjioni Jugor sh.aPrizren , njesite e saj operuese (Suharekë, Malishevë dhe Dragash) si dhe Impianti për trajtimin e ujrave të zeza(ITUN).	70433702-23-1220-1-2-1	07.04.2023	07.04.2025	PM GROUP SH.P.K.	7,492.50€	
Furnizim me material zyrtar administrativ	70433702-23-1895-1-2-1	06.06.2023	05.06.2026	MEDIATEC H & PRINT SH.P.K.	54,294.50€	
Sigurimi i automjeteve zyrtare,TPL	70433702-23-2365-2-3-6	14.04.2023	Brenda 12 muajve	Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.	9,210.51€	
Furnizim me ujëmatës të prodhimit të ujit,ujëmatës ultrasonik-DN 600mm.	70433702-23-2396-1-3-6					Data e vendimit te anulimit: 11.05.2023 (Asnje ofertues nuk ka qene i pergjegjshem)
Servisimi dhe rimbeshellja (viklimi) i elektromotorrëve dhe pompave te KRU Hidoregjioni Jugor sh.a Prizren	70433702-23-2910-2-2-1					Data e vendimit te anulimit 06.06.2023 (Asnje ofertues nuk ka qene i pergjegjshem)
Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit duke perfshire edhe vendosjen e ujematesave jashte prones private ne komunen e Malisheves LOT I Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit duke perfshire edhe vendosjen e ujematesave jashte prones private ne Qytetin e Malisheves LOT II Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit duke perfshire edhe vendosjen e ujematesave jashte prones private ne fshatin Banje KKMalisheve	70433702-23-3198-5-2-1	26.06.2023 23.06.2023		LOT I : : " Muratori " SH.P.K. LOT II: Grup i Operatorëve Ekonomik BAJRAM HA.GASHI B.I.; PRO Constructions SH.P.K	LOTI: 54,767.10€ LOT II : 74,077.00€	
Furnizim me atomjete te rreja per trasport malrash(CARGO)	70433702-23-3327-1-2-1					Data e vendimit te anulimit 29.05.2023 (Asnje ofertues nuk ka qene i

						pergjegjshem)
Furnizim me vaj për pompat e ITUN-së.	70433702-23-3449-1-3-6	31.05.2023	Brenda 20 diteve	Shaip B. Gashi B.I	8,420.00€	
Furnizim me fatura rrollne për nevojat e KRU"Hydroregjioni Jugor" Sh.A Prizren.	70433702-23-4112-1-2-1					05.06.2023 Ky aktivitet i prokurimit anulohet pasi qe asnje nga ofertuesit nuk ka qene i pergjegjshem
Furnizim me paisje për dezinfektim dhe pjese rezerv për Klor gas dhe Hipoklorit Natriumi.	70433702-23-5205-1-2-1	31.07.2023	01.08.2025	Afrim Sadriu B.I.	25,234.20€	
LOT 1 Furnizimi, montimi, ndërtimi dhe puna e dorës me materiale për objekte të ndryshme dhe punë në teren sipas nevojave të KRU Hydroregjioni Jugor Sh.A - për zonën e Prizrenit dhe Dragashit LOT 2 Furnizimi, montimi, ndërtimi dhe puna e dorës me materiale për objekte të ndryshme dhe punë në teren sipas nevojave të KRU Hydroregjioni Jugor Sh.A - për zonën e Suarekes dhe Malisheves	70433702-23-5230-5-2-1					Kjo procedure ndodhet ne fazen e ankesave (OSHP)
Furnizim me automjete te reja(të pashfrytëyuara) për transport mallrash(CARGO)	70433702-23-5847-1-2-1	18.07.2023	20.09.2023	"DELFIN AUTO " SH.P.K.	82,400.00€	
Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit duke perfshire edhe vendosjen e ujematesve jashte pronës private, Fshati Bllacë - Suharekë Faz-I	70433702-23-5952-5-2-1					Data e vendimit te anulimit 11.07 .2023 Mungesa e ofertave
LOT 1 REHABILITIMI, NDRYSHIMI, ZONIMI DHE ZGJËRIMI I RRJETIT TË UJESJËLLESIT DHE INTEGRIMI NË SISTEMIN EKZISTUES TË UJËSJELLËSIT NË FSHATIN „GËRNÇAR“ KOMUNË E PRIZRENIT. LOT 2 SHTIMI I KAPACITETIT PËRMES SIGURIMIT TË BURIMEVE TË REJA DHE INTEGRIMI NË SISTEMIN EKZISTUES	70433702-23-5953-5-2-1	10.08.2023	10.10.2023	Grup i Operatorëve Ekonomik BAJRAM HA.GASHI B.I.; GASHI ING SH.P.K	54,818.00€	

TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATIN „GËRNÇAR“ KOMUNË E PRIZRENIT. LOT 3 REHABILITIMI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT PEHD O 90 mm NË RRUGËN “JUNUS EMRE DHE SYLEJMAN DRINI” - PRIZREN						
LOT 1 FURNIZIMI ME ELEKTROPOMPA DHE PAISJE KOMANDUESE LOT 2 FURNIZIM ME INVERTER (RREGULLATORË) FREKUENTOR & PAJISJET PËR LËSHIM TË BUTË NË PUNË - SOFT STARTERËT LOT 3 Paisjet për komunikim dhe dirigjim nga distanca “Stacioni i pompimit – rezervuar” dhe ngjajshëm	70433702-23-6034-1-2-1	LOT I: 04.08.2023 LOT II dhe Lot III : 04.08.2023	Lot I :05.08.2025 LOT II dhe LOT III: 05.08.2025	LOT I : N.P.SH."HIT ERM EL" LOT II dhe LOT III: " EJONA " SH.P.K.	LOT I: 77,821.44€ LOT II: 6,077.48€ LOT III: 10,444.14€	
Nderrim i rrjetit të ujesjellesit nga materiali ACC për qytetin e Prizrenit Lot 1 Rehabilitimi i rrjetit të ujesjellesit, duke përfshirë vendosjen e ujmatësive jashtë pronës private në rrugën “Gucia”-Prizren Lot 2 Rehabilitimi i rrjetit të ujesjellesit, duke përfshirë vendosjen e ujmatësive jashtë pronës private në rrugën “Drejtësia”-Prizren Lot 3 Rehabilitimi i rrjetit të ujesjellesit, duke përfshirë vendosjen e ujmatësive jashtë pronës private në rrugën “Avdi Shala”-Prizren Lot 4 Rehabilitimi i rrjetit të ujesjellesit, duke përfshirë vendosjen e ujmatësive jashtë pronës private në rrugën “Nehat Berisha”-Prizren	70433702-23-6208-5-2-1	LOT I: 15.08.2023 LOT II: 11.08.2023 LOT III: 15.08.2023 LOT IV: 11.08.2023	LOT I: 16.10.2023 LOT II: 16.10.2023 LOT III: 16.10.2023 LOT IV: 16.10.2023	LOT I: Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. CO-ING ; N.P.T. Xërxa LOT II: Grup i Operatorëve Ekonomik BAJRAM HA.GASHI B.I.; GASHI ING SH.P.K LOT III: Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. CO-ING ; N.P.T. Xërxa LOT IV: Grup i Operatorëve Ekonomik BAJRAM HA.GASHI B.I.; GASHI ING SH.P.K	LOT I: 45,007.16€ LOT II: 26,986.60€ LOT III: 22,062.00€ LOT IV: 47,779.84€	
Furnizim me fatura rrolne për nevojat e KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren - RITENDER	70433702-23-6522-1-2-1					Data e vendimit të anulimit 26.07.2023 Ne mungesë të ofertuesve

RITENDER-Servisimi dhe rimbeshellja (viklimi) i elektromotorrëve dhe pompave	70433702-23-7053-2-1					Njoftim per dhenie 17.10.2023
Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit te ujesjellesit duke perfshire edhe vendosjen e ujematesve jashte pronës private, Fshati Bllacë - Suharekë Faz-I - RITENDER	70433702-23-7305-5-2-1	14.08.2023	14.11.2023	" Muratori " SH.P.K.	167,800.58€	
Lot 1 Furnizim me paisje per detektimin e rrjetit te ujesjellesit Paisje akustike per zbulimin e rrjedhjeve te ujit. Lot 2 Furnizim me paisje per detektimin e rrjetit te ujesjellesit Paisje per detektim te rrjetit nentoksor GPR (Radar)	70433702-23-7809-1-2-1					Kjo procedure ndodhet ne Ankese (OSHP)
Furnizim me reagjent dhe paisje te ndryshme per pune ne laborator per analiza Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike.	70433702-23-8120-1-2-1	22.09.2023	21.09.2026	Flamur Isufi B.I.	35,834.50€	
Furnizim me kompjuter per nevojat e KRU Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren	70433702-23-8143-1-3-6					Data e vendimit te anulimit 28.08.2023
Furnizim me fatura rrollne per nevojat e KRU"Hydroregjioni Jugor" Sh.A-Prizren-Ritender 2	70433702-23-8151-1-2-1					Ndodhet ne fazen e Rivleresimit
Shërbimi me internet dhe DTV në pikat e KRU"Hydroregjioni Jugor" sha - 6 LOTE	70433702-23-8551-2-2-1					Ne pritje te vendimit nga KE per rritje te vleres se parashikuar
LOT 1 REHABILITIMI, NDRYSHIMI, ZONIMI DHE ZGJËRIMI I RRJETIT TË UJESJËLLESIT DHE INTEGRIMI NË SISTEMIN EKZISTUES TË UJËSJELLËSIT NË FSHATIN „GËRNÇAR“ KOMUNË E PRIZRENIT-RITENDER.	70433702-23-8789-5-2-1	15.09.2023	15.11.2023	" Infra-Plus " SH.P.K.	174,371.40€	
Ritender-Furnizim me kompjuter	70433702-23-9582-1-3-6					Njoftim per dhenie te kontrates 17.10.2023

Furnizim me zhavor dhe pjese betonike	70433702-23-9679-1-2-1					Hapja e ofertave do te behet me 19.10.23
Furnizim me Klor Gas dhe Hipoklorit Natrium	70433702-23-10304-1-2-1					Hapja e ofertave do te behet me 27.10.23

X. INVESTIMET KAPITALE

XI. ZBATIMI I STRATEGJISË PËR ZVOGLIMIN E UPF-së

MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË PËR ZVOGËLIMIN E UJIT TË PAFATURUAR

Raporti për Progresin e Arritur

KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A

Periudha Raportuese: **Korrik – Shtator 2023**

1. Emri dhe mbiemri i Koordinatorit/Personit të ngarkuar për koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e Strategjisë:	Besar Grazhda
2. Sa ishte shkalla e UPF për vitin 2022 (%):	53.7%
3. Cili është caku i planifikuar për zvogëlimin e UPF për vitin 2023 (%):	
4. Rezultatet e realizuara në 3-mujorin e tretë të vitit 2023 (%):	
7) Korrik : 72.19 % ; 8) Gusht : 70.37 % ; 9) Shtator : 69.98 % ; mesatarja 3-mujore: 70.85 %	
5. Kapacitetet organizative të Kompanisë të angazhuara për zbatimin e Strategjisë:	
5.1 Numri i ekipeve të kontrollit secilën prej njësive operative:	Në K.R.U"Hydroregjioni-Jugor", operojnë 8-ekipe të kontrollit në nivel regjional. <ul style="list-style-type: none">• Prizren – 4 ekipe• Suharekë – 2 ekipe• Malishevë – 1 ekipe• Dragash – 1 ekip
5.2 Numri i ekipeve të shkyçjes për secilën njësi operative:	Secili ekip i kontrollit, ka autorizim të plotë, të shkyçjes së konsumatorëve
5.3 Sa shpesh mbahen takimet e menaxhmentit për monitorim dhe koordinim të aktiviteteve për zvogëlimin e UPF?	Dy herë në muaj
5.4 Aktivitete tjera (të përshkruhen)	<ul style="list-style-type: none">• Janë evidentuar numri i sakte i sakte i konsumatorëve pa konsum (edhe sipas Njësive punuese)• Janë duke u inspektuar të gjithë këta konsumatorë

<p>6.1 identifikimi dhe shkyçja e konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujin); (sa konsumatorë janë shkyçur gjatë periudhës raportuese për shkak të kyçjes ilegale/vjedhjes së ujit? – te mos përfshihen shkyçjet për mospagesë të faturave)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Lidhjet e paligjshme: 80 • Konsumatorë të legalizuar: 593 • Verifikimi i ujëmatësve: 6,590 • Nr. i leximeve të gabuara: 58 • Vizitat sipas ankesave: 537
<p>6.2 identifikimi dhe procedimi penal i konsumatorëve problematik (ilegal apo që vjedhin ujin); (sa konsumatorë janë proceduar penalisht për veprime të sanksionuara me Kodin Penal, si: vjedhja e manipulimi me ujëmatës, manipulimi i pllombës etj.).</p>	<p>Raste të dorëzuara në gjykatë: 14</p>
<p>6.3 identifikimi dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional (sa ujëmatësja janë zëvendësuar gjatë periudhës raportuese?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekipe të kompanisë gjatë kësaj periudhe në nivel regjional, gjithësej kanë zëvendësuar (ndërruar) 351 -ujmatesa, të konsumatorët që ujëmatësit kanë qenë jashtë funksionit (defekt).
<p>6.4 instalimi i ujëmatësve të konsumatorët që nuk kanë ujëmatës (sa ujëmatësja janë instaluar gjatë periudhës raportuese?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekipe të kompanisë gjatë kësaj periudhe në nivel regjional, gjithësej kanë instaluar 593 -ujëmatësja, të konsumatorët që nuk kanë pasur ujëmatësja.
<p>6.5 riparimi i rrjedhjeve (sa është numri i rrjedhjeve të riparuar?)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i rrjedhjeve të riparuar në nivel regjional 739 -riparime në sistemin e ujesjellesit
<p>6.6 zëvendësim i rrjetit të vjetërsuar (sa është gjatësia e rrjetit të zëvendësuar)</p>	<p>Zëvendësimi i rrjetit të vjetërsuar dhe zgjerimi i zonës së shërbimit, janë instaluar gypa të PE-100 :</p> <ul style="list-style-type: none"> • DN 110=1,212m' • DN 75=510m' • DN 63=2,230m' • DN 20 – 50 =450m'
<p>6.7 aktivitete tjera - të përshkruhen (p.sh. formimi i DMA-ve, pllombimi/vulosja e ujëmatësve, menaxhimi i presioneve, kontrolli aktiv i rrjedhjeve etj.).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dedektimi i rrjetit të ujesjellesit në nivel regjional me gjatësi L=4,240 m', 191 raste për detektim ku janë gjetur 116 defekte. • Bazhdarime të ujëmatësve në nivel regjional janë 269 riparime/bazhdarime të ujëmatësve. • Pllombime të ujëmatësve gjithësej 464 ujëmatësja poashtu edhe 0 riblombime të ujëmatësve. • Monitorim i zonave DMA, në baza mujore • Analizim dhe monitorim i MNF (Minimum Night Flow) nga të dhënat e datalogerëve në DMA

7. Vështirësitë/problemet kryesore gjatë zbatimit të Strategjisë: (të përshkruhen)	
<p>Vështirësitë dhe problemet të cilat më së shumti hasen gjatë zhvillimit të aktiviteteve për zvogëlimin e humbjeve janë :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çasje të vështirësuar në leximin e ujëmatësve shtëpiak/komercial • Besueshmëri e ulët në leximin e ujëmatëve të prodhimit dhe atyre zonal • Mungesë e investimeve direkte në zvogëlimin e UPF • Koordinimin më specifik, në mes të palëve të interesit, Kompani Rajonale, Komuna, Ministri • Mungesë e paisjeve profesionale për detektimin e rrjedhjeve • Vështirësi në grumbullimin/matjen e të dhënave nga tereni • Vështirësi në identifikimin e ujëmatësve shtëpiak të pa-kalibruar • Aktivitete senzibilizuese me konusmatorë 	

XII. RAPORTIM FINANCIAR PËR MINISTRIN E FINANCAVE

XIII. ORGANOGRAMI

